



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 066/8
Prishtinë, më 16 prill 2009
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 16 PRILL 2009**

Seancën e drejtoi Kryetar i Kuvendit zoti **Jakup Krasniqi**, kurse i ndihmoi, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, **Xhavit Haliti**.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 65 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullën 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Nuk pati asnjë propozim për amendamentimin e rendit të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 26 mars 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë Publike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armët,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03/L-090 për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik në Kosove për vitin 2008,
10. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008, dhe
11. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e një anëtar i jo-ekzekutiv të Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 26 mars 2009

Kuvendi miratoi, pa vërejtje Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 26 mars 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Naim Rustemi** parashtoi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin **Ahmet Shala**, lidhur me marrëveshjen e PTK-së, me pesë kompani tjera, për të konkurruar si konzorcium në tenderin e telefonisë mobile në Shqipëri.

Ministri Shala i'u përgjigj pyetjes së deputetit Rustemi.

Deputetja **Luljeta Shehu** parashtoi pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, zotin **Fatmir Limaj**, lidhur me gjendjen e hekurudhës në relacionin Krushë e Vogël – Prizren.

Ministri Limaj i'u përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** parashtoi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, lidhur me masat e ndërmarra për lehtësimin e pajisjes së qytetarëve me dokumentacion personal.

Ministri Pajaziti iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputetja **Gjylnaze Syla** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin **Enver Hoxhaj**, lidhur me nivelin e analfabetizmit në Kosovë.

Ministri Hoxhaj i'u përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin **Ahmet Shala**, lidhur me privatizimin e ndërmarrjes bujqësore "Dubrava" të Istogut.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadaj- Bujupi.

Deputetja **Edita Tahiri** parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, lidhur me lëshimin e dokumenteve të Serbisë në Republikën e Kosovës.

Ministri Pajaziti i'u përgjigj pyetjes së deputetes Tahiri.

Deputeti **Emrush Xhemajli** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, z. **Ahmet Shala**, lidhur me fillimin e procedurës së privatizimit të PTK-së.

Ministri Shala i'u përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, z. Ahmet Shala ose për ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, z. **Lutfi Zharku**.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Kosara Nikoliç** parashtroi pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural zotin **Idriz Vehapi**.

Ministri Vehapi i'u përgjigj pyetjes së deputetes Nikoliç.

Deputetja **Kaqusha Jashari** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, **Enver Hoxhaj**, lidhur me vendimin e Qeverisë për përcaktimin e moshës së profesorëve ordinar të cilët punojnë në Universitet. .

Ministri Hoxhaj i'u përgjigj pyetjes së deputetes Jashari.

Deputetja **Njomza Emini** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, **Enver Hoxhaj**, lidhur me rishikimin e plan-programeve shkollore në të tri nivelet e arsimit në Kosovë.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Emini.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala, lidhur me zbatimin e kodit të etikës dhe të qeverisjes në ndërmarrjet publike.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, që ta marr fjalën.

Sadik Idriz tha se flet edhe në emër të Grupit Parlamentar ” 7+”. Komisioni ka bërë një punë mjaft të mirë dhe ka arritur t’i identifikoj pothuaj të gjitha problemet nga kjo lëmi. Sektori i shëndetësisë është i një rëndësie shumë të madhe për çdo shoqëri dhe sidomos në Kosovë ballafaqohemi me vështirësi të shumta, si shoqëri në tranzicion, në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve.

Komisioni ka paraqitur në Raport vlerësimet dhe rekomandimet e tij. Komisioni nuk ka pasur mundësi që t’i vizitoj të gjitha institucionet private shëndetësore.

Ministri **Alush Gashi** falënderoi anëtarët e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë për reformat e filluara në shëndetësi. Si ministri, tha se kemi dhënë komentet për këtë raport.

Sa i përket licencimit të institucioneve shëndetësore private, deri më tani kanë aplikuar 850 institucione.

Ministri u zotua se gjatë këtij viti do të sjellin në Kuvend, 4-5 projektligje që lidhen me fushën e shëndetësisë.

Deputetja **Mimoza Ahmeti**, nga Grupi Parlamentar i PDK-së, tha se Raporti i ofruar ka për qëllim vënien në pah të mangësive të ligjit në fuqi. Qëllimi është që të gjitha instancat relevante të kontribuojnë së bashku që t’a avancojmë veprimtarinë private në shëndetësi. Në emër të Grupit Parlamentar i PDK-së, i ftoi deputetët që t’a votojnë Raportin në fjalë.

Deputetja **Nurishahe Hulaj**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së, e falënderoi komisionin për rekomandimet e bëra dhe shfaqti brengosjen për mos përfshirje të buxhetit të veçantë për realizimin e udhëzimeve administrative në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Nga të dhënat që kemi, tha ajo, del se buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë është i vogël. Grupi Parlamentar i LDK-së, e përkrah Raportin e ofruar.

Deputeti **Shkumbin Demaliaj**, nga Grupi Parlamentar i AKR-së, fillimisht tha se si Grup Parlamentar e përkrahim raportin e ofruar. Ai pati vërejtje se përse në komisionin për licencim të veprimtarive private në shëndetësi është paraparë përfshirja e përfaqësuesit nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Deputetja **Gjylnaze Syla**, nga Grupi Parlamentar i AAK-së, tha se të dhënat që veçanërisht Komisioni ka marrë nga terreni, janë të mirëseardhura për një raport sa më komplet. Grupi Parlamentar i AAK-së, e përkrah Raportin për veprimtarinë private në shëndetësi.

Deputetja **Qamile Morina**, nga Grupi Parlamentar i LDD-së, tha se anëtarët nga grupi parlamentar i LDD-së kanë marr pjesë aktive në komisionet përkatëse dhe e mbështesim

raportin e ofruar. Si të metë mjaft të madhe të shumicës së institucioneve private në shëndetësi, ajo ceku mungesën e dokumentacionit shëndetësor dhe të evidencave, ashtu siç parashihen me ligj.

Deputetja **Radmila Vujović** nga Grupi Parlamentar i SLS, tha se në emër të grupit parlamentar e përkrahim këtë Raport.

Deputetja **Vezira Emrush**, nga Grupi Parlamentar “Zajedno”, vlerësoi se projektligjet bazike nga lëmi i shëndetësisë janë më se të domosdoshme të procedohen në Kuvend. Në emër të grupit parlamentar e përkrahim këtë raport.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: **Bahri Hyseni, Naser Rugova, Armend Zemaj, Edita Tahiri, Ibrahim Makolli, Flora Brovina**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryesuesi e hodhi në votim Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për63,
Kundër.....3,
Abstenime..... 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës ta prezantojë Projektligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** tha se ky projektligj ka rëndësi të veçantë nga se ka pasur vakum juridik për shumë vjet. Ky projektligj parasheh formimin e Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar, e cila do të ketë bashkëpunim me prokuroritë apo gjykatat kompetente. Pasuria e konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore nuk i përket fushëveprimit të këtij projektligji. Kjo agjenci do t'i raporton dy herë në vit Kuvendit të Kosovës. Projektligji përcakton edhe nxjerrjen e udhëzimit administrativ, si akt nënligjor që e nxjerr ministri i Drejtësisë. Ajo tha se kostoja financiare e Projektligjit është 1.200.000 euro.

Projektligji nuk është voluminoz, ka gjithsejtë 13 nene dhe është në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ministrja ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Radmila Vujović**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Vezira Emrush** si dhe deputetët: **Hajdin Abazi**, **Riza Smaka**, **Rrustem Mustafa**, **Adem Hajdaraj**, **Naim Rrustemi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër-----6,
Abstenime-----7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Projektligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë Publike

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës ta prezantojë Projektligjin për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Ministri **Zenun Pajaziti** tha se ky projektligj ka filluar të hartohet nga ministria e Punëve të Brendshme më 2008 dhe se gjatë hartimit na kanë ndihmuar edhe ekspertë të huaj të cilët e mbështesin ministrinë me projekte konkrete. Rregullimi i kësaj fushe me ligj shkon në favor të sigurimit të përgjithshëm të rendit për gjithë qytetarët e Kosovës. Projektligji ka rëndësi të veçantë, sepse do të mundësojë zbatimin e ligjshmërisë që ka të bëjë kundërvajtjet lidhur me rendin dhe qetësinë publike në përgjithësi. Ky projektligj rregullon edhe çështjen e kundërvajtjeve ndaj personave të cilët e shkelin rendin dhe qetësinë publike. Ky projektligj, për periudhën kohore 2009-2011 nuk do të ketë implikime buxhetore në buxhetin e Kosovës.

Projektligji është në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ministri ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim këtë Projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, **Rrustem Mustafa**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Zafir Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Agim Veliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Gani Geci**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Bojan Stojanović**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët: **Driton Tali**, **Bahri Hyseni**, **Riza Smaka**, **Njomza Emini**, **Emrush Xhemajli** dhe **Naim Rrustemi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----1,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Projektligjin për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armët

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës ta prezantojë Projektligjin për armët.

Ministri **Zenun Pajaziti** tha se ky projektligj rregullon mbajtjen, përdorimin, ruajtjen blerjen, prodhimin, tregtimin, transportimin e armës brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe eksportimin e armëve nga Republika e Kosovës.

Në Kosovë kemi një numër mjaft të madh të armëve të llojeve të ndryshme, që paraqesin rrezik për popullatën. Projektligji ka rëndësi të posaçme dhe ka një kosto buxhetore e cila është pasqyruar në dokumente.

Projektligji është në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ministri ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjin për armët.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, si dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Rrustem Mustafa**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Agim Veliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzan Novobërdali**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Gani**

Geci, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Bojan Stojanoviç**, si dhe deputetët: **Shkumbin Demaliaj**, **Berat Luzha**, **Riza Smaka** dhe **Nurishahe Hulaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Projektligjin për armët.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03/L-090 për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre.

Kryesuesi, ftoi Kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ta marrë fjalën.

Gani Koci, kërkoi nga deputetët që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për seancë tjetër plenare, në mënyrë që të harmonizohen disa çështje me komisionet e tjera.

Pas kësaj kërkesë, kryesuesi kërkoi të deklarohen kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Njomza Emmini**, në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Myfera Shinik**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS, **Bojan Stojanoviç**, përkrahën propozimin e Kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Berim Ramosaj**, kërkoi që ky projektligj të dërgohet edhe në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----1,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi kërkesën e Kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, për seancë tjetër plenare.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme që ta marrë fjalën.

Sabri Hamiti i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Punë të Jashtme ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe Kuvendit i'a ka paraqitur raportin me rekomandime. Ai i ftoi deputetët që t'i votojnë amendamentet e paraqitura.

Kryesuesi hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Punë të Jashtme.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41 (i riformuluar), 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54 dhe 55.

Amendamenti 42 nuk u votua me arsyetimin se i njëjti ishte i pa objekt.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41,
Kundër-----21,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Ligjin për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.

9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik në Kosove për vitin 2008.

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

Gani Koci, tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik në Kosove për vitin 2008. Ky Kuvend ka amendamentuar Ligjin e prokurimit dhe shtrohet si domosdoshmëri që Qeveria ta formojë grupin punues për ndryshimin e këtij ligji për shkak rrethanave të reja të krijuara. Ai i ftoi deputetët që ta aprovojnë këtë raport.

Kryesuesi hapi debatin për Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik në Kosove për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxheri**, si dhe deputetët: **Naim Rrustemi**, **Driton Tali**, **Myzejene Selmani**, **Myrvete Pantina**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi e hodhi në votim Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik në Kosove për vitin 2008.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për38,
Kundër.....20,
Abstenime..... 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik në Kosove për vitin 2008.

10. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

Gani Koci, tha se Organi Shqyrtues i Prokurimit është organ kryesisht i ri, i cili është themeluar para 6-7 muajve. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka kërkuar që Organi Shqyrtues i Prokurimit të na dërgoj vlerësimet shtesë.

Ai i ftoi deputetët që t'a aprovojnë këtë raport.

Kryesuesi hapi debatin për Shqyrtimin e Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, si dhe deputetët: **Ibrahim Makolli**, **Naim Rrustemi**, **Driton Tali dhe Ismet Beqiri**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi, e hodhi në votim Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për20,
Kundër.....36,

Abstenime..... 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008.

11. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e një anëtari joekzekutiv të Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ta marrë fjalën.

Gani Koci, tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimin e Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtari joekzekutiv në Bordin Drejtues të Bankës Qendrore. Komisioni për Buxhet dhe Financa ia ka dhënë rekomandimet e veta dhe ftoi Kuvendin që ta propozimin.

Kryesuesi hapi debatin për emërimin e një anëtari joekzekutiv të Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Shkumbin Demaliaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryesuesi **Xhavit Haliti**, para se ta hidhte në votim propozimin, konstatoi se nuk ka kuorum për ta votuar, pasi që në sallë mungonte numri i mjaftueshëm i deputetëve për vazhdimin e seancës, andaj shqyrtimi i mëtejshëm i tij shtyhet për seancën e radhës.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 19:13 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**